

25/06/2020

## **Fundjavë në Berat/ Turistët bjellorusë vizitojnë muzeun “Onufri”**



Një grup turistësh bjellorusë por dhe shumë vizitorë vendas dhe të huaj vizituan të dielën Muzeun e Ikonografisë “Onufri”, në Berat.

Ata zgjodhën të kalojnë fundjavën në Berat, i cili vijon të mbetet destinacion i rëndësishëm edhe në këtë periudhë.

Shqipëria ishte destinacioni i parë për këtë sezon i 189 turistëve bjellorusë, të cilët mbërritën nga Minsku, në 12 qershor në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

Turistët po shijojnë qëndrimin e tyre në Shqipëri, duke frekuentuar plazhet e jugut si dhe duke vizituar monumentet e kulturës.

Bregdeti i mrekullueshëm, temperaturat e larta, peizazhet e larmishme natyrore, natyra e virgjër, kulinaria... etj, janë vetëm disa nga atraksionet turistike të vendit tonë, që kanë joshur 189 vizitorët nga Bjellorusia të udhëtojnë drejt vendit tonë.

Çarteri turistik erdhi me kompaninë “Belavia”, linja ajrore kombëtare e Bjellorusisë. Me çeljen e sezonit turistik, pritet që Boeing 737-800 të realizojë udhëtime të tilla

turistike dy herë në javë, të martë dhe të premte.

— [ata.gov.al](http://ata.gov.al)